

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 21. 09. 2017

Lënda: Kriteret për pranimin e stafit akademik të ftuar për vitin akademik 2017 - 2018.

V E N D I M

Departamenti i Restaurimit arkitektonik dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në mbledhjen e datës 21. 09. 2017 vendosi:

Kriteret për pranim të personelit akademik të ftuar:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në profilin Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatët preferohen me mesatare mbi 9 në lëndët e disiplinave, ku kërkojnë të kontribuojnë, ose të kenë aktivitet të spikatur profesional në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatet që zotërojnë gradën Doktor, ose të jenë në proces të mbrojtjes së Doktoraturës në fushën e Arkitekturës (preferohen studentët e shkollës së Doktoraturës në FAU).
3. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime etj, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi. (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
4. Preferohen kandidatë me eksperiencënë mësimdhënie në specialitetin apo fusha të ngjashme me disiplinat ku aplikojnë për të kontribuar si personel akademik i ftuar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për stafin akademik të ftuar:

1. Kërkesë të veçantë me shkrim për seicilen lëndë ku kërkon të konkurojë (jo më shume se pesë lëndë – kërkesat pa lëndë të specifikuara, nuk shqyrtohen nga komisioni).
2. Dokument identifikimi.
3. C. V të përgjithshme të përqendruar.(short bio, jo më e gjatë se një faqe), portfolio e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve.
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar).
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron.
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë, apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë.

Shënim: Dorëzimi i dokumentacionit nga kandidatët, do të kryhet pranë sekretarisë së Departamentit të Arkitekturës, (FAU) deri në datën 12.10.2017, ora 16:00



Vlerësimi i kandidatëve për spersonelin akademik të ftuar:

Komisioni i vlerësimit, përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: përgjegjësi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënës i lëndës (apo të lëndëve të ngjashme).

- a. Vlerësimi i përmbajtjes të dosjes së dorëzuar nga konkurenti (60 %)
- b. Vlerësimi i konkurentit nëpërmjet një interviste në komisionin e vlerësimit (40%)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës, dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse.

Përgjegjësi i Departamentit të Restaurimit arkitektonik dhe Teknologjisë së Arkitekturës:

Dr.Endrit TUZI